



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 24 , datë 30.09.2024

Për

“CAKTIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE DHE
PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2025 TË AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Z. Armer	Juka	Anëtar
3. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
4. Z. Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare znj. Elbona Moshaj në mbledhjen e datës 30.09.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.2.2017 me propozim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- PËR CAKTIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE DHE PROJEKTBUXHETIN E VITIT 2025 TË AKEP.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1, e nenit 114, pika 1, e nenit 115 dhe pika 2, e nenit 117, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr.9918/2008**);
2. Neni 5, neni 7, i ligjit nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, (**ligji nr. 46/2015**);
3. Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (**ligji nr. 10 296/2010**);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.2.2017 (**Rregullore nr.7**);

5. Vendim i Këshillit Drejtues nr. ___, datë ___. ___. 2024, "Për mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet, si Agjent Tatimor për vitin 2025";
6. Urdhër i Brendshëm nr.98, datë 26.06.2024, "Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe hartimin e projektbuxhetit të AKEP për vitin 2025".

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Fondi i parashikuar i shpenzimeve administrative dhe projektbuxheti i AKEP për vitin 2025 (**Projektakti**);
2. Relacioni mbi projektvendimin për "Caktimin e projektfondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin për vitin 2025 të AKEP" (**Relacioni**);
3. Projektakti miratues – Vendim i Këshillit Drejtues për "Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative, për vitin 2025 të AKEP" (**Projektvendimi**);

V Ë R E N :

1. Në zbatim të parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 117, të ligjit nr. 9918/2008, paraqitet për miratim pranë Këshillit Drejtues të AKEP, projektvendimi për "Caktimin e projektfondit të shpenzimeve administrative, për vitin 2025".
2. Fondi i shpenzimeve administrative të parashikuara për vitin 2025, përmban zërat standarde të shpenzimeve për:
 - Paga për personelin;
 - Sigurime shoqërore dhe shëndetësore;
 - Materiale;
 - Shërbime;
 - Investime.
3. Parashikimi dhe llogaritja e shpenzimeve sipas zërave të sipërcituar bazohen në:
 - 3.1 Strukturën dhe organikën e AKEP të miratuar me vendimin e Kuvendit nr.56/2018, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)";
 - 3.2 Nivelin e pagave sipas pozicioneve të punës dhe përcaktimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
 - 3.3 Përcaktimet ligjore mbi detyrimet financiare për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
 - 3.4 Nevojat e institucionit për materiale, shërbime dhe investime në nivel të indeksuar me çmimet mesatare referencë të tregut për mallrat dhe shërbimet sipas zërave, normën e inflacionit, kushtet dhe specifikat e tyre lidhur me amortizimin e pajisjeve, pritshmërinë e realizimit të shpenzimeve për të garantuar veprimtarinë normale të institucionit dhe përmbushjen e rolit dhe funksioneve rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në përputhje me objektivat dhe programin e punës për vitin 2025.
4. Projektbuxheti për vitin 2025, reflekton mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara, sipas burimeve ligjore të financimit për AKEP të

parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore e më konkretisht, nenin 119, të ligjit nr.9918/2008, dhe nenin 27, të ligjit nr. 46/2015, që realizohet nëpërmjet zërit të pagesave për AKEP të parashikuara për vitin 2025.

5. Të ardhurat e parashikuara sipas burimeve të financimit, janë llogaritur në të njëjtin nivel me atë të fondit të shpenzimeve administrative në total, në përputhje me statusin ligjor të AKEP si person juridik, publik, jo buxhetor dhe i pavarur, i krijuar me ligj të veçantë.
6. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin e Këshillit Drejtues për “Caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetit të vitit 2025 të AKEP”, jep sqarime të hollësishme ligjore dhe financiare mbi të gjithë zërat e fondit të shpenzimeve të parashikuara dhe projektbuxhetin e vitit 2025.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen projektaktin “Caktimi i fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxheti i AKEP për vitin 2025”, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 117, të ligjit nr.9918/2008 dhe rregullat e përgjithshme të parashikuara në ligjin nr.10296, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të pikës 1, të nenit 114, pikës 1, të nenit 115, të ligjit nr. 9918/2008 dhe Rregullores së Brendshme të AKEP;

V E N D O S:

1. Të miratojë fondin e shpenzimeve administrative të parashikuar, në shumën 399,977,000 lekë (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të ndarë sipas zërave që paraqiten në Lidhjen 1, bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Fondi i shpenzimeve administrative të parashikuar dhe projektbuxheti për vitin 2025, sipas pikës 1 të mësipërme, t’i dërgohen Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918/2008.
3. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e procedurave deri në miratimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin për vitin 2025 të AKEP.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Tomi Frashëri

ANËTAR
Lorenc Bako

ANËTAR
Armer Juka

ANËTAR
Bleron Dokle



16/